

THIRRJE PËR PROJEKT PROPOZIME NË FUSHËN E MENAXHIMIT TË MBETURINAVE

Hyrje

Situata aktuale e menaxhimit të mbeturinave në Kosovë është mjaft brengosëse për shkak të shumë arsyeve. Problemet kyçe kanë të bëjnë me infrastrukturën joadekuatë, që si pasojë prodhon një menaxhim dhe trajtim joadekuat të problemeve operacionale si p.sh mungesa e zbatimit të reformave që kërkohen me ligj, zbatimin e pamjaftueshëm të politikave dhe të legjislacionit, mbulueshmëria të pamjaftueshme me shërbimet për mbledhjen e mbeturinave, niveli i ulët i inkasimit, vazhdueshmëria e deponive ilegale, etj. Këto sfida rezultojnë me problemin e rritjes së vazhdueshme të gjenerimit të mbeturinave, gjë që prodhon pasoja negative për mjedisin ku jetojmë dhe për shëndetin publik.

Për të adresuar këto probleme dhe për të pasur një mjedis më të shëndetshëm, institucionet kosovare kanë zhvilluar kornizën strategjike dhe kanë miratuar aktet ligjore bazike. Për zbatimin e plotë të kornizës ligjore dhe këtyre politikave në jetën e përditshme të qytetarëve, nevojiten intervenime shtesë.

Njëkohësisht janë edhe disa organizata joqeveritare që janë aktive në këtë sektor. Ato kontribuojnë në zbutjen e këtij problemi qoftë përmes iniciativave të organizuara apo atyre individuale për mbledhjen e mbeturinave dhe pastrimin e deponive ilegale. Mirëpo, për të arritur më tepër rezultate, nevojitet një angazhim më i madh qytetar.

Paralelisht, në Kosovë janë ndërmarrë disa projekte dhe iniciativa edhe nga partnerët për ndihmë në zhvillim. Zyra Gjermane për Zhvillim Ndërkombëtar (GIZ) dhe Zyra Zvicërisht për Bashkëpunim në Kosovë (SCO-K) janë dy nga ata që e përkrahin këtë fushë. Përveç qëllimit të përgjithshëm për përmirësimin e gjendjes aktuale, kjo thirrje ka për qëllim të krijojë sinergji dhe plotësim në mes të këtyre iniciativave, sidomos me projektin DEMOS¹, që është projekt i financuar nga SCO-K për përkrahjen e qeverisjes lokale në Kosovë.

Duke i marrë parasysh këto që u thanë më lartë, projekti Promovimi i Shoqërisë Demokratike (DSP II) ka vendosur të hapë një thirrje të veçantë për projekt propozime në fushën e menaxhimit të mbeturinave. Pritet që këto projekte të kenë kontribut të drejtpërdrejt në Objektivën I të DSP-së: Qytetarët e Kosovës dhe organizatat e shoqërisë civile rrisin kërkesën ndaj institucioneve dhe marrin rol aktiv në kërkim të shërbimeve të cilësisë së lartë, qeverisjes së mirë dhe integritit të pakicave².

Qëllimi i përgjithshëm

Qëllimi i përgjithshëm i DSP II është që të arrijë ndryshime të dukshme dhe të qëndrueshme e që rrjedhimisht kontribuojnë në zhvillimin e një shoqërie demokratike në Kosovë.

Qëllimi i kësaj thirrje për projekt propozime është që të përkrahë angazhimin dhe kontributin e qytetarëve dhe shoqërisë civile në menaxhimin e mbeturinave në Kosovë.

¹ Për më shumë vizitoni <http://helvetas-ks.org/demos/>

² Për informata shtesë rreth projektit DSP II, klikoni <http://kcsfoundation.org/dsp/>.

Fushat prioritare për intervenim

Projekt propozimet që dorëzohen për këtë thirrje duhet të adresojnë një ose më tepër fusha prioritare të listuara më poshtë:

1. Përfshirjen e qytetarëve dhe shoqërisë civile në ciklin e menaxhimit të mbeturinave, përfshirë dhe jo vetëm: uljen e gjenerimit të mbeturinave, klasifikimin (ndarjen) e mbeturinave në fillim të ciklit, mbledhjen, transportimin, riciklimin dhe deponimin e mbetjeve;
2. Përfshirjen e qytetarëve dhe shoqërisë civile për ushtrimin e ndikimit në institucionet lokale dhe ato qendrore për përcaktimin e prioritetëve, planifikimit, buxhetimin dhe vendim-marrjen që ndërlidhet me menaxhimin e mbeturinave. Kjo mund të përfshijë:
 - a. Planifikimin dhe buxhetimin për menaxhimin e mbeturinave
 - b. Shtrirjen e shërbimit për mbledhjen e mbeturinave
 - c. Inkasimin
 - d. Eliminimin e deponive ilegale
 - e. Zbatueshmërinë dhe inspektimin
 - f. Mekanizmat për raportim nga qytetarët, etj.
3. Përfshirjen e qytetarëve dhe shoqërisë civile në monitorimin e institucioneve lokale dhe qendrore në menaxhimin e mbeturinave;
4. Rritjen e transparencës së institucioneve lokale dhe qendrore për çështjet që kanë të bëjnë me menaxhimin e mbeturinave;
5. Rritjen e llogaridhënies nga lartë - poshtë dhe nga poshtë - lartë për institucionet lokale dhe qendrore, për çështjet që kanë të bëjnë me menaxhimin e mbeturinave;
6. Rritjen e njohurive dhe vetëdijësimin e qytetarëve për çështjet që kanë të bëjnë me menaxhimin e mbeturinave, për obligimet dhe pasojat.

Secili projekt propozim duhet të ketë parasysh:

1. Përfshirjen e perspektivës gjinore në menaxhimin e mbeturinave;
2. Kontributin e menaxhimit të mbeturinave në adresimin e integritit social, ekonomik dhe kulturor të grupeve të marginalizuara të shoqërisë (komunitetet pakicë, të rinjtë, të moshuarit, gratë, etj.).

Nivelet e ndërhyrjes

Ndërhyrjet e propozuara mund të targetojnë:

- nivelin lokal, përkatësisht organizatat dhe iniciativat me bazë në komunitet që adresojnë sfidat në nivel të lagjes, fshatit ose komunës, lidhur me menaxhimin e mbeturinave;
- nivelin ndërkomunal, përkatësisht idetë e projektit që trajtojnë çështjet e menaxhimit të mbeturinave nëpërmjet bashkëpunimit ndërkomunal;
- niveli kombëtar, përkatësisht iniciativat që adresojnë çështjet e menaxhimit të mbeturinave në mbarë vendin, qoftë sfidat që kanë të bëjnë me politika, legjislacion apo me kapacitetet e nevojshme.

Kriteret e aplikimit

DSP II përmes kësaj thirrje për projekt propozime synon të ofrojë mbështetje financiare për organizatat e shoqërisë civile dhe iniciativat qytetare që do të zbatojnë projekte, iniciativa apo aktivitete të shoqërisë civile që janë cilësore dhe kuptimplote dhe që kontribuojnë në ndryshime të ndjeshme, pozitive në fushën e menaxhimit të mbeturinave në Kosovë.

Për të qenë të pranueshëm në procesin e aplikimit, aplikantët duhet:

- të jenë organizatë aktive e shoqërisë civile në Kosovë;
- të jenë organizatë jofitimprurëse;
- të jenë drejtpërdrejt përgjegjës për menaxhimin e projektit dhe të mos ketë rol ndërmjetës; të kenë potencial për të dëshmuar kapacitetet e tyre për menaxhimin e aktiviteteve të sugjeruara.

Numri i aplikimeve për grante

Aplikantët e kualifikuar mund të aplikojnë me më shumë se një projekt propozim. Megjithatë, në të njëjtën kohë ju mund të keni vetëm një grant nga DSP. Grantistët aktual të DSP-së mund të aplikojnë por ata nuk mund të përfitojnë nga dy grante në të njëjtën kohë nga DSP.

Kohëzgjatja

Kohëzgjatja maksimale për zbatimin e projekteve të propozuara është 12 muaj³.

Buxheti

Shuma minimale dhe maksimale e financimit nuk është e caktuar. Aplikantët inkurajohen të paraqesin buxhete efektive dhe reale për projektet e propozuara

Si të aplikoni?

Aplikantët duhet të aplikojnë me projekt propozime që janë në përputhje me këtë thirrje dhe të përdorin formularin standard të përdorur në DSP II.

Aplikimet të shkruara me dorë nuk do të pranohen.

Aplikantët duhet të plotësojnë formularët e aplikimit në gjuhën shqipe, serbe ose angleze.

Aplikacionet duhet të dërgohen vetëm në format elektronik në versionin .doc ose .pdf në e-mailin dsp aplikimi@kcsfoundation.org me titullin ***“DSP –Thirrje për menaxhim të mbeturinave-emri i plotë i aplikantit (akronimi)”***

E-mail do të përfshijë dokumentet e mëposhtme:

- Formularin e plotësuar të aplikimit për grantet e projektit

³ Projektet e aprovuara nuk pritet të fillojnë me zbatim përpara datës 1 shtator. Të gjitha projektet dhe aktivitetet duhet të përfundojnë më së voni deri në muajin tetor të vitit 2018.

- Formularin e buxhetit
- Certifikata e regjistrimit si OJQ; Për nismat qytetare, duhet të sigurohet një dëshmi e funksionimit të iniciativës qytetare.

Afati i fundit për të aplikuar për këtë thirrje është **14 qershor 2017**.

Vlerësimi

Aplikacionet do të vlerësohen nga një organ i pavarur i përbërë nga 5 anëtarë të quajtur Bordi i Granteve dhe Çmimeve (GAB). Gjatë vlerësimit të aplikacioneve, përveç rëndësisë dhe cilësisë, do të merren parasysh edhe fushat prioritare të propozuara dhe nivelet e ndërhyrjes.

Njoftimi i vendimit

Varësisht nga mbledhja së Bordit të Granteve dhe Çmimeve (GAB), KCSF do të njoftojë të gjithë aplikantët për vendimin. Lista e përfituesve të granteve do të vendoset në www.kcsfoundation.org/dsp.

Kontakti

Për çfarëdo pyetje që mund të keni rreth përgatitjes së aplikacioneve ose rreth aplikimit për grante, mund të na drejtoheni përmes e-mailit dsp@kcsfoundation.org.